Kronikë

Shkodër/ Vritet me armë zjarri 20-vjeçari në fshatin Guci e Re, nuk dihen motivet e ngjarjes (EMRI+VIDEO)

Një vrasje me armë zjarri ka ndodhur mesditën e sotme në fshatin Guci e Re në rrethinat e Shkodrës. Ngjarja ka ndodhur sa kalon shkollën e Gucisë së Re.

Flet xhaxhai i viktimës: Familja nuk kishte hasmëri! Djali shkonte dhe vinte në Dukagjin

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
27 Shkurt, 14:59 | **Përditësimi: 27 Shkurt, 17:01**

Share

SHKODËR - Një vrasje me armë zjarri ka ndodhur mesditën e sotme në fshatin Guci e Re në rrethinat e Shkodrës. Ngjarja ka ndodhur sa kalon shkollën e Gucisë së Re.

Mësohet se i vdekur ka mbetur 20-vjeçari Pavlin Preka, që sipas policisë dyshohet se është vrarë me armë zjarri. Policia ndodhet në vendngjarje. Ende nuk dihen rrethanat e ngjarjes dhe kush janë autori/ët.

Sakaq ka folur për mediat xhaxhai i viktimës, Prek Preka i cili ka deklaruar se familja nuk kishte hasmëri me askënd, ndërsa djali shkonte e vinte shpesh në Dukagjin.

LEXO EDHE:
Vrau 67-vjeçarin në Kurbin për motive pronësie, autori pranon fajin: E qëllova me armë, jam penduar! Lihet në burg

Njoftimi i policisë:

Shkodër/Informacion paraprak

Rreth orës 14:50, në fshatin "Guci e Re", është gjetur pa shenja jete shtetasi Paulin Preka, rreth 20 vjeç, dyshohet i vrarë me armë zjarri.

Menjëherë në vendngjarje kanë shkuar shërbimet e Policisë dhe grupe të Forcës Kombëtare të Sigurisë, Njësia Shkodër.

Ndërkohë ëdhtë ngritur një Grup i posaçëm hetimor dhe nën drejtimin e Prokurorisë po punon intensivisht për sqarimin e rrethanave, dokumentimin ligjor, identifikimin dhe kapjen e autorit/ve.

Lajmi ne përditësim...

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 16:54

Shkodër/ Vrasja e 20-vjeçarit në Guci e Re, flet xhaxhai i viktimës: Familja nuk kishte hasmëri! Djali shkonte dhe vinte në Dukagjin

20-vjeçari Pavlin Preka mbeti i vrarë mesditën e sotme në fshatin Guci e Re pranë Shkodrës. Ende nuk dihen rrethanat e ngjarjes dhe autori i vrasjes.

Sakaq, ka folur për gazetarët xhaxhai i viktimës, i cili u shpreh se viktima nuk ka pasur asnjë problem me askënd dhe se ishin një familje e thjeshtë. Familja nuk kishte hasmëri, deklaroi Prek Preka.

'Asnjë problem nuk ka pasur, ai ka jetuar me babën dhe me vëllain e vet në Dukagjin. Ky jeton ka 15 vjet, që ka bërë shtëpinë. Që në atë kohë ka jetuar herë në Dukagjin, herë këtu. Në Dukagjin ka do bagëti, punon pak tokë aty, ka do bagëti. Me probleme si tanë të tjerët, me halle. Nuk ka nevojë të bëjë apel, shtetl ka marrë masat e veta.'

G.K/Shqiptarja.com

Share

G.K/Shqiptarja.com

TAG: Vrasje me armë zjarri | Shkodër | Pavlin Preka | Guci e Re

Komento

Komente

Bim: 27/02/2025 16:01
Arsyet e jo motivi. Meloni shqip gazetar se nuk eshte vone
Përgjigju

Shkodra: 27/02/2025 15:52
Ca e ka edmond preken ky qe asht shok me pllum gjoken
Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH .COM

Sondazhi i ditës:
Mandarina me pesticide, sa të sigurta janë produktet që konsumojmë?

27 Shkurt, 09:24

Shumë | Pak | Aspak

Lajme të tjera

VKM/ Rikualifikimi i hyrjes së Shkodrës, qeveria miraton fondin 402 milionë lekë për shpronësimet
26 Shkurt, 15:55

SPAK çon për gjykim Bardh Spahinë: Shkarkoi drejtorin e Ujësjellësit të Shkodrës, nuk zbatoi vendimin e Gjykatës për ta kthyer në detyrë
26 Shkurt, 14:15

Tentoi të hynte në Shqipëri, arrestohet në Han të Hotit malazezi i shpallur në kërkim ndërkombëtar (EMRI)
26 Shkurt, 09:09

Shkodër/ 30- vjeçari kanoset me armë zjarri gjatë një konflikti të çastit, shpallet në kërkim autori
25 Shkurt, 20:23

Vrasja e 67-vjeçarit dje në Kurbin/ Arrestohet autori, u prangos me armën e zjarrit me vete! Policia: Krimi ndodhi për motive pronësie (EMRI)

Elvis Hila

25 Shkurt, 16:35

Motër e vëlla dyshohet se u helmuan me pesticide! 7-vjeçarja rëndë në QSUT, Prokuroria heton mjekët për neglizhencë por dhe veprimet e prindërve
25 Shkurt, 15:22



Misteri me humbjen e jetës së 3-vjeçarit në Shkodër, mjeka Dollenberg: Edhe një grip bëhet i rrezikshëm për fëmijët që nuk kanë anti-trupa
25 Shkurt, 14:43

Vrasja dje në Kurbin, viktima u qëllua 6 herë me pistoletë, 10 të shoqëruar! Pista e hetimit, hakmarrja dhe konflikti për pronën

Elvis Hila

25 Shkurt, 10:07

Kurbin/ Po punonte në pyll, 67-vjeçari vritet me 3 plumba në fshatin Vilëz, dyshohet për konflikt pronësie (EMRI)
24 Shkurt, 18:18

Eduard Zaloshnja: Regjistrimi i emigrantëve në KQZ, Berati e Dibra më mirë, Vlora e Shkodra më keq

Eduard Zaloshnja

24 Shkurt, 16:21

Misteri në Shkodër/ Ndërron jetë 3-vjeçari, në gjendje të rëndë motra 7 vjeç! Dyshohet helmim, por spitali nuk ka laborator toksikologjik
24 Shkurt, 16:19

U qëllua me plumb në kokë nga partneri, nëna e 3 fëmijëve ndërron jetë pas 6 ditësh në spitalin e Shkodrës! Manaj nuk pranonte ndarjen

Ergys Kavaja

24 Shkurt, 10:00

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje